



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA K – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

VRHOVNI SUD K – SUPREME COURT OF KOSOVO

**Në çështjen juridike të:**

**AC-I-16-0160**

***Paditësi/Ankuesi***

**M.M. Gjilan**

***Kundër:***

***E paditura***

**Agjencia Kre e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani" nr.23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kre të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të gjyqtarit me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-2279, të datës 23/06/2016 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit, refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2279 të datës 23/06/2016.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Më 11 tetor 2013, ankuesi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme , ka parashtruar ankesë kundër vendimit të AKP-së, Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. GJI090-0188 i datës 18 shtator 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për shërbime të pa paguara në shumë prej 2,000.00 euro, nga NSH. Sh. a. h. "K", në Gjilan (në likuidim).

Dhomës së Posaçme i ka propozuar që vendimi i atakuar të anulohet dhe të obligohet e paditura që ankuesit t'i kompensoj borxhin e kërkuar.

Në mbrojtjen e saj të dorëzuar me 20 qershor 2014, AKP ka kundërshtuar ankesën e ankuesit, duke theksuar se kërkesa e ankuesit me të drejte është refuzuar si e pabazuar pasi që ai pranë Autoritetit të Likuidimit nuk ka paraqitur, fatura të rregullta të cilat ia kishte dërguar NSH-së si klientë të përfaqësuar në gjykatë sipas lëndës SCC-05-0473. Andaj Dhomës së Posaçme i ka propozuar që këtë ankesë ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Më 29 korrik 2014 ankuesi, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në Dhomën e Posaçme ka dorëzuar përgjigjen kundër mbrojtjes së të paditurës, duke theksuar se mbetet pranë ankesës së tij.

Më 26 gusht 2014 e paditura Dhomës së Posaçme i ka parashtruar kundërpërgjigje ndaj përgjegjës së ankuesit dhe nga Dhoma e Posaçme dhe prapë ka kërkuar që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pabazuar.

Më 23/06/2016, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2279 me të cilin refuzoi ankesën si të pa bazuar dhe vërtetoi vendimin e AL nr. GJI090-0188 të datë 18 shtator 2013 me arsyetim se ankuesi me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se ka

përfaqësuar NSH-në, kërkesa këto të parapara me nenin 36 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kre të Privatizimit nr. 04/L-034.

Më 18/07/2016 kundër Aktgjyqimit të DHPGJS-së, C-IV-13-2279 datë 23/06/2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) ankuesi parashtroi ankesë me të cilën konteston Aktgjykimin e ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.par.1,lidhur me nenin 8 dhe par.2 neni "n" të LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nga neni 183 i LPK-së si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, nga neni 184 i LPK-së. Sipas Ankuesit, dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, Gjykata ka dështuar të vlerësoj provat veç e veç në veçanti, autorizimin për përfaqësim nr. 136/1 të datës 10/10/2005 në lëndën në DHPGJS-ë SCC-05-0473. Si rezultat i mos vlerësimit të provave Gjykata nuk ka arritur të arsyetoj faktet vendimtare mbi të cilat është mbështetur arsyetimi . Më tutje ai pohoi se për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike është bërë edhe zbatim i gabuar i së drejtës materiale duke pasuruar NSH-në pa bazë juridike, neni 210 i LMD-së nr. 29/78 i vitit 1978.

Ankuesi i ka propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS që Aktgjykimin e ankimuar të ndryshojë dhe aprovojë ankesën e paditësit si të themeltë, apo ta prishë dhe të njëjtin ta kthej në rivendosje në shkallë të parë.

Më 20/07/2016, AKP-ja ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës, duke theksuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është i bazuar në ligj e prova dhe si i tillë ai duhet të konfirmohet. Mbi bazë e argumenteve pala kundërshtare i kërkon Gjykatës të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar .

### **Arsyetimi Ligjor**

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kre të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesës, provave të bashkangjitura dhe të mbledhura gjatë procedurës me shkrim, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Vendimi i atakuar është i drejtë, i bazuar, i arsyetuar mirë, nuk përmban shkelje procedurale, është i qartë dhe i kuptueshëm për palët dhe i përmban të gjitha faktet vendimtare mbi të cilat bazohet.

Kolegji i Apelit sikundër edhe gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara, konstaton se kërkesa e ankuesit për kompensim të shërbimeve të pa paguara ishte refuzuar me të drejtë pasi që nuk ishte e bazuar në as një provë valide dhe te besueshme me të cilën do të vërtetohej në mënyrë të padyshimte se ankuesi, për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit pranë gjykatës në mënyrë të rregullt dhe me kohë kishte dorëzuar te NSH-ja faturat për pagimin e këtyre shërbimeve. Këto fatura ankuesi nuk i kishte parashtruar as te Autoriteti i Likuidimit me rastin e dorëzimit të kërkesës së tij, ai këtë nuk e kishte bërë as pas kërkesës për informata plotësuese të cilat nga ai i kishte kërkuar Autoriteti i Likuidimit dhe ishte informuar me kohë. Ai këtë nuk e kishte bërë as para kolegjit të Specializuar si përgjigje ndaj Urdhrit të Gjyqtarit të datës 19/03/2014 për parashtrimin e provave apo dëshmime shtesë. Dhe së fundi as para Kolegjit të Apelit me rastin e parashtrimit të Ankesës kundër Aktgjykimit të ankimuar.

Faturën nr. 1/5 të datës 13.06.2013 që ankuesi ia kishte bashkangjitur ankesës nuk e konsideron provë valide as kolegji i Apelit pasi që e njëjta i referohet rasteve të tjera dhe jo rastit të pohuar nga ankuesi SCC-05-0473. Përderisa për rastet e pohuar në këtë faturë ankuesi nuk ka parashtruar asnjë provë me të cilat do të dëshmohej se ishte i autorizuar për përfaqësim.

Sipas nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006i takon paditësit që të paraqes faktet dhe provat me të cilat vërtetohen faktet. Për rastin në fjalë një gjë të tillë ankuesi nuk e ka bërë.

Në bazë të këtyre arsyeve ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë ka paguar taksën gjyqësore për parashtrimin e ankesës në shumë prej 30 euro më 17/08/2016 prandaj nuk ngarkohet me taksë.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 26 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_

## URDHËR PËR REGJISTRIN

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tekë:

- Palët
- Gjyqtari Kryesues i Kolegjit të Specializuar në lëndën ,C-IV-13-2279.

Gjyqtari kryesues , Ilmi Bajrami \_\_\_\_\_